

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“CELA-CO” SH.P.K.

Sot, më date **05.02.2021**, une i nënshkruari:

- **Mikel Cela** lindur ne Kutalli me 28.04.2001 ,shtetas shqiptar, rezident ne Berat , identifikuar me karten e identitetit me Nr. **034226573** ,madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar; në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” kam vendosur të themeloje një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar **“CELA-CO” SH.P.K.** (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

Neni 1

Emri i Shoqërisë është: **“CELA-CO” SH.P.K**

Neni 2

(1)Selia e shoqërisë ndodhet në adresën:-Berat,Kutalli,fshati Samatic, rruga “Azbi Shehe” pasuri me nr.38/45, e zone kadastrale nr.3256 .

(2)Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: *cela-co@yahoo.com*
Shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë.

Neni 3

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 10 vjet dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

- Import – eksport,grumbullim tregtim te fruta perime, etj.

-Megjithate shoqeria ka te drejte qe te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100 000** (njqind mije) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues Mikel Cela: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **100 000** leke që përbën **100 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve do të jetë në para .

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themelor mund te behet vetem pasi Asambleja e ortakeve me shumice e ka dekretuar kete dhe per me teper te gjithe ortakët jane te detyruar qe ta repektojne dhe te kontribuojne ne para ose ne natyre ne baze te vendimit te shumices se asamblese

Neni 7:

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen pëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) shitblerjes;(me te drejten e parablerjes nga ana e ortakeve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të trasferueshme ndërmjet ortakëve,përsa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitakit themeltare janë ligjerisht të trasferueshme me rrugë trashgimnie.

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqerisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqerisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve ,përfjashtimi nga e drejta e votës dhe te tjera modalitete per funksionimin e organit vendimmarres percaktohen ne statutin e shoqerise.

Neni 9

Administrimi

Aministratori i shoqërisë emërohet Z **Luli Cela** lindur ne Samatice me 02.03.1973 ,shtetas shqiptar, rezident ne Berat , identifikuar me kartën e identitetit me Nr. **035836084** ,madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i zgjedhur per nje periudhe **5** vjecare me te drejte rizgjedhje.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratorit janë te percaktuara qarte ne statutin e shoqërisë.

Neni 10

Viti financiar-ekspertët

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përbastimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxierien e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cialt është i detyruar që tja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 11

Prishja-riorganizimi i shoqërisë

Modalitetet per prishjen dhe riorganizimin e shoqërisë janë te percaktuara ne statutin e shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i Ndryshuar.

Neni 12

Akti i Themelimit është hartuar ne 4 kopje origjinale.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

Mikel Cela

